

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm** , Gjyqtarja **Ilirjana Hoti** , me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit R. P. nga fsh.M. K Gj. , për shkak te veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë , PP.nr.650/17 të datës 22.11.2017, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **10.04.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Mone Syla si dhe të akuzuarit R.P. , mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari **R. P.** nga fsh. M. K Gj. , ku edhe tani banon, i biri M.. dhe i nënës Gj. e gjinisë D., lindur me dt. ... në Gj. , ka te kryer shkollën e mesme , i pa punë-student, e gjendjes se mesme ekonomike, shqiptar ,shtetas i R. Kosovës, i pa martuar ,me nr. ID ....

### Ë s h t ë f a j t o r :

#### Sepse:

- me dt. **04.03.2017** rreth orës **17:00 min** , në fsh. Pj.n K Gj. ,i shkakton lëndime te lehta trupore personit tjetër ,në atë mënyrë qe për shkaqe xhelozie , i pandehuri ne Gj. ,me automjetin e tij te markës “...” me tabela te regjistrimit ..., e merr te dëmtuarën -te dashurën e tij S. G. nga Gj. dhe pasi qe e dërgon në fsh. P. ,brenda në automjet fillimisht e fyen dhe e ofendon te dëmtuarën ,e me pas e godet me grushte në fytyre ,e kap për flokësh dhe njëkohësisht i drejtohet me fjalë “këqyrem në sy ti e din se kush jam unë ,unë jam shef ,unë jam zotëni ,gjersa ti buke nuk ke për te ngrenë “e qe si pasojë e atyre te goditurave i shkakton lëndime te lehta trupore .

**-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188/1 te KPRK-ës .**

Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4,41,43,46,73 , nenit 188 par.1 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, te akuzuarit i shqipton;

### DËNIM ME GJOBË

Dënim me gjobë në shumën prej **500,00 (pesëqind).-€**, ne te cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim ne kohëzgjatje prej 12 ditësh duke llogaritur nga dt. 04.03.2017 e gjere me dt. 16.03.2017 , ashtu qe për çdo ditë te kaluar ne paraburgim do te llogaritet nga 20(njëzet) euro qe i bie 240 ( dyqind e katër dhjetë) euro, ndërsa pjesën tjetër te mbetur te dënimit me gjobë ne shume prej 260 (**dyqind e gjashtëdhjetë** ) euro ,i akuzuari është i obliguar qe ta paguaj ne në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë përkatësisht pjesa e mbetur e dënimit në shumë prej **260 (dyqind e gjashtëdhjetë ) euro** nuk mund te ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara

sipas nenit 46 të KPRK-së ,atëherë i njëjti i zëvendësohet me dënim burgimi ne kohëzgjatje prej **13 (trembëdhjetë) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)**.

E dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil .

I akuzuari obligohet që të paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej **20.00 €** si dhe në emër të paushallit gjyqësor shumë prej **30,00 €** , të gjitha këto në afat prej **15 ditësh**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore - DP në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën, PP.nr.650 /17 të datës 22.11.2017, kundër të akuzuarit R.P. nga fsh. M. K Gj. ,për shkak te veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.1 të KPRK-së .

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me të dt. 10.04.2018, Prokurori i shtetit Mone Syla , lexojë aktakuzën PP.nr.650/17 të datës 22.11.2017 deklaroi se mbetet në tërësi pranë Aktakuzës.

I akuzuari R. P. , gjate shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë theksoi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se deri te kjo vepër ka ardhur ne afekt, për shkak te sjelljeve te saj te pahijshme ne lokalim tim ,premtojë se një veprim i tillë nuk do te përsëritet dhe do te jem me i kujdesshme ,kërkojë falje nga e dëmtuara për lëndimin e shkaktuar , andaj i propozojë gjykatës qe te merr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, kërkim faljen ndaj te dëmtuarës si dhe faktin qe është hera e pare qe kam ra ndesh me ligjin te me shqiptojë një dënim me te butë .

Duke u deklaruar lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, prokurori i shtetit Mone Syla, deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi qe i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike te pranimi te fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje ligjore dhe prova te mjaftueshme .

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari R. P. : **me dt. 04.03.2017** rreth orës **17:00 min** , në fsh. P.K Gj. ,i shkakton lëndime të lehta trupore personit tjetër ,në atë mënyrë qe për shkaqe xhelozie , i pandehuri në Gj. me automjetin e tij te markës “...” me tabela te regjistrimit ....., e merr te dëmtuarën -te dashurën e tij S. G. nga Gj. , dhe pasi qe e dërgon në fsh. Pj. ,brenda në automjet fillimisht e fyen dhe e ofendon te dëmtuarën ,e me pas e godet me grushte në fytyre ,e kap për flokësh dhe njëkohësisht i drejtohet me fjalë “këqyrem në sy ti e din s kush jam unë ,unë jam shef ,unë jam zoteni ,gjersa ti buke nuk ke për te ngrënë “e qe si pasojë e atyre te goditurave i shkakton lëndime te lehta trupore .

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit të cilët ne shqyrtimin fillestar vullnetarisht e kanë pranuar fajësinë ,për shkak te se cilës gjykata nuk ka administruar provat , gjykata ka ardhur ne përfundim se pranimi i fajësisë nga i

akuzuari është bere ne pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjate pranimit te fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit te fajësisë ,pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet ne faktet dhe provat qe i përmban aktakuza ,në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje te qarte ligjore ose gabime faktike .

Gjykata nga te cekurat me lartë ka ardhur ne përfundim se ne veprimet e te akuzuarve formohen te gjitha elementet e veprës penale te përshkruara si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur qe te akuzuarit të shpalle fajtor dhe ta gjykohen ne bazë te ligjit ,me pare duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike te tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj te akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPK-së ,të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit .Rrethana rënduese nuk gjeti ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh ,pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, premtimin se nuk do të përsërisë vepra penale të tilla apo të ngjashme ,sjelljen korrekte në gjykim, kërkim falja nga e dëmtuara për lëndimin e shkaktuar , pendimin e shprehur për veprën e kryer , faktin se i njëjti me pare nuk ka qene i dënuar , të gjitha këto ndikuan që Gjykata ka ardhur në përfundim që të akuzuarit ti shqiptoj dënim me gjobë ne shume prej 500 (pesëqind ) euro , në te cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim ne kohëzgjatje prej 12 ditësh duke llogaritur nga dt. 04.03.2017 e gjere me dt. 16.03.2017 , ashtu qe për çdo ditë te kaluar ne paraburgim do te llogaritet nga 20(njëzet) euro qe i bie 240( dyqind e katër dhjetë) euro, ndërsa pjesën tjetër te mbetur te dënimit me gjobë ne shume prej 260 (dyqind e gjashtëdhjetë ) euro i akuzuari është i obliguar qe ta paguaj ne në afatin prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi ,me bindje dhe besim se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer, shkallen e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar ne nenin 463/2 te KPP-ës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushalli gjyqësor bazohet në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,**  
**P. nr. 805/17 më datë 10.04.2018**

**Sekretarja juridike,**  
**Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,**  
**Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej  
15 ditësh nga dita e marrjes së tij në dorëzim Gjykatës së Apelit në  
Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.